



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:095705
Datë: 01.10.2020
Numri i dokumentit: 01154372
C.nr.108/2017

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil, përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V. Q.. nga fshati C., të cilën me autorizim e përfaqëson, Y. H, avokat në Gjilan, ndaj të paditurës K.e Gj-D K e A në Gj, me objekt kontesti anulim i vendimit dhe konkursit, jashtë seance, më datë 01.10.2020 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Hedhet poshtë padia e paditëses V. Q.-H nga fshati C, Ke Gj, e parashtruar ndaj të paditurës K e Gj-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, për anulimin e vendimit dhe konkursit, si e pasafatshme.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësja V. Q nga fshati C, përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate me dt., ka parashtruar padi ndaj të paditurës, me objekt kontesti: anulim i vendimit dhe konkursit. Mes tjerash, paditësi në petitumin e padisë kërkon që të anulohet konkursi i publikuar nga e paditura dhe vendimi mbi përzgjedhjen e kandidatit për lëndën mësimore mësimdhënës i lëndës së Psikologjisë pranë Shkollës së Mesme të Mjekësisë “...” në Gj ashtu që të detyrohet e paditura në që duke anuluar konkursin dhe vendimin për zgjedhjen e kandidatit, të publikojë konkurs të ri për këtë lëndë mësimore dhe kështu t’i mundësohet paditëses që t’i nënshtrohet procedurave të punësimit, tërë këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Pos tjerash, paditësja i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e më hollësisht si në këtë padi.

Gjykata, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për rregullësinë e padisë sa i përket afatit për paraqitjen e padisë në gjykatë, gjeti se padia e paditëses është parashtruar pas afatit ligjor, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja fillimisht si palë e pakënaqur me vendimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për pozitën e shpallur nga e paditura për lëndën e Psikologjisë në Shkollën e Mesme “...” në Gj.... gjatë vlerësimit të aplikacioneve fare nuk është përzgjedhur dhe ftuar në intervistë, ashtu që e njëjta e pakënaqur me këtë vlerësim, më datë ... ka parashtruar ankesë te e paditura D Ke A në Gj për mospërfshirje në listën e ngushtë për intervistim, e për të cilën ankesë e paditura fare nuk ka vendosur, edhe pse sipas nenit 78 parag.2 të Ligjit të Punës do të duhej të vendoste për këtë ankesë në afat ligjor prej 15 ditësh

nga data e pranimit të ankesës, e si datë e fundit për vendosje nga e paditura ka qenë data..., ndërsa si afat ligjor për të kërkuar mbrojtje gjyqësore me padi paditësja referuar nenit 79 të Ligjit të Punës, rezulton se ka qenë afati nga data ...deri më datën..., gjë që në rastin konkret paditësi padinë e ka parashtruar në gjykatë me dt....., pra pas afatit ligjor.

Sipas nenit 78 parag.2 të Ligjit të Punës është paraparë se:“*Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëshjetë (15) ditëve, nga data e pranimit të kërkesës*”, ndërsa sipas nenit 79 të po këtij ligji, është paraparë se: “*Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente*”.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se paditësja ka pasur të drejtë ligjore që në mënyrë të lirshme ti ushtrojë këto të mjete juridike në rrugë gjyqësore konform afatit të paraparë me nenin 79 të Ligjit të Punës, andaj, mos shfrytëzimi i këtyre mjeteve juridike brenda afateve të caktuara ka si pasojë edhe humbjen e të drejtës për mbrojtje gjyqësore, dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar paditëses, por për shkak se kjo e fundit ka dështuar që me kohë t’i shfrytëzoj këto mjete juridike të cilat i ka pasur në dispozicion.

Sipas nenit 391 pika f) e LPK-së parashihet se gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj.

Paditësja në rastin konkret ka humbur të drejtën në mbrojtje gjyqësore pasi që padinë e ka parashtruar jashtë afatit ligjor nga shkaqet e lartëcekura dhe te parapare me dispozitën e nenit 391 pika (f) e LPK-së, andaj gjykata ka vendosur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale, Gjykata vendosi në bazë të nenit 450 dhe 463 të LPK-së.

Nga se u tha më lartë e në bazë të nenit 142 dhe nenit 391 pika f) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
C.nr.108/2017, më datë 01.10.2020

Gjyqtari,
Blerim BESHTICA, d.v.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.